



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.92/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.92/2021 të datës 22.02.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi, Rr. "Dëshmoret e Sibovcit", Nr.43, në Komunën e Obiliqit, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.92/2021 të datës 22.02.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës sipas, sipas kontratës së punës me numër Nr.Ref.0435 të datës 03.09.2011, në pozitën "Radiokomunikues" në Drejtorin Rajonale në Prishtinë, në Departamentin e Sigurisë Publike, me datë 22.02.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:741/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim material nga pakoja emergjente COVID-19 për muajin, janar 2021, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila këtë shumë e ka ndarë për muajt: Janar, Shkurt dhe Mars 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.02.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës deri me datën e nxjerrjes së këtij vendimi nuk ka sjell provat e kërkuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:741/2021 e datës 22.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimi i Punësimit i datës 02.02.2021; Vendimi i datës 14.01.2008; Kontrata e punës e ankuesit Nr.0435,



e datës 03.09.2011; Lista e pagës e ankuesit për muajin janar; Orari i punës për muajin janar 2021, i Stacionit Policor – Obiliq; kartela e punës e ankuesit dhe letërnjoftimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dëshmive të ofruara nga ankuesi, konstaton se ankuesi është në marrëdhënie punë në Policinë e Kosovës respektivisht në Drejtorin Rajonale në Prishtinë, në Departamentin e Sigurisë Publike, sipas kontratës së punës me numër Nr.Ref.0435 të datës 03.09.2011, në pozitën "Radiokomunikues" dhe në bazë të kontratës së punës ankuesi kryen këto detyra "Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të ndërrimit, zyrtari operon në Radiolidhje për të komunikuar më njësitë patrulluese brenda stacionit. Raporton menjëherë të udhëheqësi informatat që dëmtojnë statusin e sigurisë në rajonin e përgjegjësisë për atë stacion. Pranon të gjitha informatat hyrëse, i regjistron ato dhe i përcjell tek udhëheqësi për ti gjykuar dhe marr vendim".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*, si dhe duke ju referuar detyrave të punës që kryen ankuesja nga pozita "Radiokomunikues", konstaton se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmës dhe të mirëmbajtjes, në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit administrativo-teknik dhe mbështetës .

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës"*, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të*



ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.92/2021

Hysni MUSTAFA

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.